



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KP.nr. 24/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit N.N.T “Auror” me numër të biznesit 810357443, me seli në Mitrovicë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat B.K. me seli në Mitrovicë, kundër të paditurit “The north Unicorn” Sh.p.k me numër të biznesit 810112186 me seli në Prishtinë Rruga Muharem Fejza Royal C15/13 nr. 3, me objekt kontesti lirimi i pronës dhe kompensimi i qirasë, jashtë seance me datën 15.08.2023 merr këtë :

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit N.N.T “Auror” me numër të biznesit 810357443, e ushtruar më datën 12.05.2021, kundër të paditurit The north Unicorn” Sh.p.k me numër të biznesit 810112186, me objekt kontesti lirimi i pronës dhe kompensimi i qirasë.

Shpenzimet e procedurës mbeten barë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 12.05.2023 pranë kësaj Gjykate, përmes të autorizuarit avokat B.K., ka ushtruar padi, kundër të paditurit “The north Unicorn” Sh.p.k, me objekt kontesti lirimi i pronës dhe kompensimi i qirasë, me të cilën ka kërkuar që të aprovet kërkesë padia e paditësit të obligohet i padituri që të liroj lokalin dhe të kompensoj shumën prej 4.484,00 Euro në emër të qirasë së pa paguar.

Paditësi përmes parashtresës së datës 11.08.2023, i është drejtuar kësaj gjykate dhe ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia e ushtruar ndaj të padituri, pasi që palët kanë arritur marrëveshje për zgjidhjen e këtij kontesti.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës për tërheqje të padisë, konstatoj se e njëjtë po e tërheq padinë, andaj konform nenit 261 të LPK-së, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, ndërsa për shpenzimet vendosi në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KP.nr.24/23, datë 15.08.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.